

PLANI ZHVILLIMOR I SHKOLLËS (PZHSH)

2022-2026



Emri i shkollës:

Sh.F.M.U “Dituria”

Vendi:

Shkabaj

Komuna:

Prishtinë

PZhSh dhe rishikimi
i aprovuar nga:

Data e aprovimit:

Data e rishikimit (të ardhshëm):

Nënshkruar nga Kryetari i KDSH:

Përmbajtja

1.Hyrje	3
1.1. Motivi për plan zhvillimor	4
1.2. Fushat e veprimit.....	4
2. Metodologjia	Error! Bookmark not defined.
3. Të dhënat për shkollën	5
3.1 Përmbledhje e të dhënave bazë të shkollës	5
3.2 Të dhënat për orët e planifikuara dhe të mbajtura (në dy vitet e fundit)	6
3.3 Suksesi i nxënësve sipas lëndëve	6
3.4 Mungesat e nxënësve dhe braktisja.....	7
3.5 Analiza e gjendjes - Analiza SWOT	8
4. Vizioni dhe misioni i shkollës.....	9
4.1. Vlerat.....	10
4.2. Parimet	10
5. Strategjia	11
5. 1. Fushat e intervenimit.....	11
1.Mjedisi i të nxënit	11
2.Mësimdhënia dhe të nxënit	12
3. Bashkëpunimi dhe partneritetet (komuniteti, autoritetet, donatorët, kompanitë).....	13
4. Gjithëpërfshirja	13
5. Performanca dhe përgatitja për jetë.....	14
6. Tabela e rreziqeve	15
7. Buxheti.....	16
Shtojcë	17
Informatat bazë të projektit.....	17

1.Hyrje

Se sa shumë e kanë dashur mësimin njerëzit në te kaluarën dhe se sa shume kanë sakrifikuar për një gjë të tillë e kuptojmë edhe përmes Hoxhë Arif Shala një nga fshataret e këtij lokalitet, i cili edhe pse kishte bërë të gjitha përgatitjet për të shkuar në Haxh, duke parë vështirësitë që i kishin nxënësit për të shkuar në shkollën që gjendej ne Kastriot dhe rreziqet që i kishin gjatë rrugës, vendosi që atë vit të mos shkonte në Haxh dhe mjetet që i kishte të grumbulluara të ndërtonte një vend ku nxënësit do të mësonin. Kështu ai ndërtoj dy dhoma mësimi, një korridor, dhe një zyre për arsimtar. Shtëpia e tij në vitin 1968 u bë pronë e përbashkët e nxënësve dhe familjes se tij. Shkolla punoj tri vite në këto rrethana, por me rritjen e numrit të nxënësve u bë e pamundur vazhdimi i mësimi në atë objekt, andaj në vitin 1971 u ndërtua një objekt tjetër me një sipërfaqe prej 276 m² , me oborr prej 70 ari e 50 m². Shkolla u ngrit nga kuvendi komunal i Prishtinës. Në vitin 1990 me kërkesat e shumta të qytetarëve të fshatit Shkabaj u vendos që fshatit Shkabaj t'i ndërtohej një shkollë e re, por një gjë e tillë nuk u realizua dhe ky projekt dështoj. Pas përfundimit të luftës në vitin 2001 me fondin për zhvillimin e Kosovës u ndan mjete për ndërtimin e shkollës së re në fshatin Shkabaj. Ndërtimi i kësaj shkollës u arrit falë përkrahjes së Drejtorisë Komunale të Arsimit të cilët ndan mjete prej 300.000 euro. Aktualisht Shkolla” Dituria” gjendet në Fshatin Shkabaj ne kilometrin e dytë te magjistrales Prishtinë- Mitrovicë.

Me 8.6.2004 u bë inaugurimi i objektit të ri me një sipërfaqe prej 520 m². Ne vitin 2004 u investua në instalimin e nxemjes qendrore, pastaj me 2005-2006 u bë rrethoja e oborrit të shkollës. Në këtë vit u bë edhe ndërtimi i fushës së jashtme të sportit, por edhe pse u bën këto investimi shkolla Dituria edhe në vitin 2022 ka nevojë për shume investime në mënyrë që të lehtësojmë procesin e të nxënësve të nxënësve. Aktualisht në pozitën e drejtorit të shkollës është Landrit Dragusha.

Karakteristikë e kësaj shkolle është rritja e numrit të nxënësve në vazhdimësi ngase kjo shkollë i përket një lagjeje e cila është në ndërtim. Nxënësve të kësaj shkolle janë të mentaliteteve shumë të përziera sepse vijnë nga te gjitha trevat shqiptare.

1.1. Motivi për plan zhvillimor

Sigurisht për të realizuar një plan në mënyrë sa më efektive dhe mundësia që ky plan të mos mbetet vetëm në letër, duhet paraprakisht të jetë mirë i menduar dhe analizuar çdo proces meqenëse çdo etapë funksionon në mënyrë zingjimore. Andaj duke e pas në konsideratë që një plan i mirë i realizuar sjell edhe suksese në një shkollë kjo bëri që të punojë shumë që të realizoj në mënyrë sa më efektive këtë plan.

1.2. Fushat e veprimit

- 1. Mjedisi i të nxënit**
- 2. Mësimdhënia dhe të nxënit**
- 3. Bashkëpunimi dhe partneritetet (komuniteti, autoritetet, donatorët, kompanitë)**
- 4. Gjithëpërfshirja**
- 5. Performanca dhe përgatitja për jetë**

3. Të dhënat për shkollën

3.1 Përmbledhje e të dhënave bazë të shkollës

Viti shkollor 2022-2026

Kategoria	Përshkrimi	Komente shtesë
Numri i nxënësve	210	Niveli fillor 112 nxënës Niveli i mesëm i ulët 98 nxënës
Numri i mësimdhënësve	25	Prej tyre 15 Bachelor, 10 Master
Numri i klasave	6	1 paralele e mësimi parafillor Niveli fillor – 6 paralele Niveli i mesëm i ulët -5 paralele (mësim me dy ndërrime)
Anëtarë i Komunitetit të Mësuarit së bashku	PO	
Internet dhe wireless	PO	Ne gjendje te mirë
Dollapë për nxënës	PO	Pjesërisht
Qasje për personat me aftësi të kufizuara	PO	Ekziston hyrje e veçantë për personat me nevoja te veçanta
Ngrohja	Po	Ngrohje qendrore
Kushtet sanitare	Po	Në nivelin e duhur
Furnizim i rregullt me ujë	PO	Brenda objektit te shkollës
Tualetet (të ndara për meshkuj dhe femra)	Po	Brenda
Çanta e ndihmës së parë	PO	Qantat e ndihmës se pare janë te pajisura me te gjitha mjetet
Pajisjet e zjarrit në shkollë	PO	Janë funksionale
EPRBM2	PO	Qe dy vite i formuar
Paralelet e ndara	Nuk ka	

3.2 Të dhënat për orët e planifikuara dhe të mbajtura (në dy vitet e fundit)

Klasa	Viti shkollor 2019/2020 (çdo vit)			Viti shkollor i tanishëm 2020/2021		
	Viti paraprak shkollor			Fundi i vitit shkollorë		
	Të planif. P1	Të mbajtura M1	Ndryshimi N1=(P1-M1)	Të planif. P2	Të mbajtura M2	Ndryshimi N2=(P2-M2)
I	819	817	2	819		
II	819	819	0	819		
III	897	897	0	897		
IV	936	936	0	936		
V	1080	1077	3	990		
VI	1120	1120	0	1140		
VII	1159	1149	10	1159		
VIII	1159	1149	10	1159		
IX	2216	2210	6	1108		
X	-					
XI	-					
XII	-					
Gjithsej	10 205	10 174	31			

3.3 Suksesi i nxënësve sipas lëndëve

Suksesi në Nivelin I – KSNA I (Klasifikim Standard Ndërkombëtar i Arsimit) Klasa V

Lënda	Klasa	Suksesi mesatar në gjysmë vjetor		Suksesi mesatar në fund të vitit shkollor	Mesatarja kombëtare nga suksesi i fundit (testi i kl V) ⁵	Nr. i nxënësve	Nr. i nxënësve të pa notuar
		I	II				
Gjuhë amtare	V	4.4	4.75	4.57		170	0
Matematikë	V	4.22	4.35	4.28		170	0
Shkencate natyrës	V	4.31	4.43	4.37		170	0

Suksesi në Nivelin II – KSNA II (Klasifikim Standard Ndërkombëtar i Arsimit) klasa IX

Lënda	Klasa	Suksesi mesatar në gjysmë vjetor		Suksesi mesatar në fund të vitit shkollor	Suksesi mesatar nga vlerësimi i jashtëm (semimatura)	Nr. i nxënësve	Nr. i nxënësve të pa notuar
		I	II				
Gjuhë amtare	IX	3.52	4.30	3.91	61.28%	22	0
Matematikë	IX	2.46	3.06	2.76	82.31%	22	0
Shkenca të natyrës	IX	3.04	3.50	3.27	77.85%	22	0

3.4 Mungesat e nxënësve dhe braktisja

Mungesat e nxënësve nga viti shkollor paraprak

Klasa	Me arsye	Pa arsye	Mesatarja e mungesave për nxënës	Numri më i madhi mungesave për një nxënës
1-5	402	14	3	
6-9	770	46	9	
10-12				
Total	1172	60		

Braktisja e nxënësve

Nxënësit që kanë lëshuar shkollën	Nxënësit kanë ndërruar shkollën, kanë konfirmuar dhe dokumentuar regjistrimin e tyre	Numri neto i nxënësve që ekanë braktisur shkollën
A	B	A-B

0	11	0
---	----	---

3.5 Analiza e gjendjes - Analiza SWOT

Për analizën e gjendjes është përdorur Analiza SWOT, në mënyrë që të identifikohen sukseset, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet për secilën fushë të përfshirë në këtë plan zhvillimor të shkollës.

Sukseset	Dobësitë
<ul style="list-style-type: none"> -Shkolla ka mekanizma adekuat dhe praktikë për të realizuar gjithpërfshirjen. -Nxënësit kanë fituar çmime në gara komunale (Vendi i dytë i nxënësit në garat e diturisë në lëndën e Biologjisë). -Mësimdhënës profesional (rreth 46% e mësimdhënësve kanë të përfunduar edhe gradën Master). -Mësimdhënës të hapur për bashkëpunim -Mësimdhënës mbështetës të cilët monitorojn dhe evidentojnë fëmijët me nevoja të veçanta. Mbështesin këta fëmijë nëpër klasa dhe ndjekin vazhdimisht përparimin e tyre. -Numër të përshtatshëm të nxënësve brenda klasës për një mësimdhënie cilësore. -Planifikimi i duhur nga ana e mësimdhënësve -Shkolla ka vëzhgim të vazhdueshëm të kamerave si dhe siguri nga stafi në përgjithësi -Nxënësve u mundësohen vizita të ndryshme nëpër institucione shkencore. -Shkolla përfshin të gjithë fëmijët në klasa të rregulla pa dallime. -Mirëmbajtja e duhur e objektit nga të gjithë akterët e shkollës: shtëpiaku i shkollës, rojet, pastruesit, mësuesit. 	<ul style="list-style-type: none"> -Infrastukturë e dobët -Mungesë e kabineteve -Mungesë e sallës së Edukatës fizike -Mungesë e bibliotekës dhe hapësirës për lexim -Mungesë e tualeteve të fëmijëve me nevoja të veçanta -Mungesë e kushteve për mësim shtesë -Numri i vogël i klasave -Mospërdorimi i paisjeve teknologjike -Mungesa e projektorëve në klasa -Mungesë e asistentëve për fëmijë me nevoja të veçanta -Mirëmbajtja e serverit mund të shkaktojë probleme pasi që nuk kemi IT -Një pjesë e prindërve mund të injorojnë bashkëpunimin
Mundësitë	Rreziqet
<ul style="list-style-type: none"> -Investimi dhe bashkëpunimi me komunitetin -Ofrimi i trajnimeve për mësimdhënësit nga OJQ. -Regjistrimi i shkollës së mesme të lartë brenda dhe jashtë vendit. -Rregullimi i oborrit të shkollës dhe gjelbërimi i tij. 	<ul style="list-style-type: none"> -Numri i vogël i donatorëve dhe investimeve nga komuna -Mungesa e buxhetit për ngritje të vazhdueshme profesionale. -Mungesa e buxhetit për investim në infrastukturë -Politikat arsimore

<ul style="list-style-type: none"> -Ndertimi i kabineteve dhe klasave shtesë me financim nga komuna dhe donatorët. -Fitimi i grandeve dhe projekteve në fushën e Edukimit. -Komuna ofron për shkollën shumë të caktuar çdo muaj. -Paisja e shkollës me mjete teknologjike nga donatorët . - Mentorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm duke përfshirë feedback (inspektoriati, MASH-i, DKA). 	<ul style="list-style-type: none"> -Mungesa e psikologut dhe pedagogut në shkollë -Mungesa e bashkëpunimit më mes të institucioneve Komunë / Qeveri / institucione (polici, prokurori, gjykatë). -Mungesa e motivimit të prindërve për pjesëmarrje në takime.
--	--

4. Vizioni dhe misioni i shkollës

Vizioni i shkollës

Shkolla jonë – institucion transformues, shkollë konkurruese që zhvillon kompetencat e nxënësve për shekullin XXI, me infrastrukturë modern dhe mësimdhënie të kualifikuar dhe kompetent.

Misioni i shkollës

Shkolla Dituria është shkollë moderne që ofron ambient të përshtatshëm dhe mundësi të barabartë për zhvillimin e kompetencave të nxënësit, me mësimdhënës të kualifikuar dhe kompetent, të përkushtuar në punën që bëjnë me nxënësit për të aritur te zhvillojnë potencialin e tyre të plotë.

4.1. Vlerat

- ♣ Gjithëpërfshirja
- ♣ Bashkëpunimi
- ♣ Mirëqenia e fëmijëve
- ♣ Përgjegjësia

4.2. Parimet

- ♣ Zhvillimi i kompetencave
- ♣ Transparenca dhe fleksibiliteti
- ♣ Kultura e shkollës
- ♣ Cilësia

5. Strategjia

5. 1. Fushat e intervenimit

1.Mjedisi i të nxënit

Objektiva strategjike 1. Sigurimi i një mjedisi të përshtatshëm, atraktiv, efektiv të të nxënit dhe mësimdhënies përmes sigurimit të infrastrukturës.

1. 1. Krijimi i hapësirës për kabinete

- 1.1.1. Rritja e hapësirës së shkollës përmes një aneksi
- 1.1.2. Ndërtimi i sallave të mëdha të cilat do të shfrytëzohen për kabinete
- 1.1.3. Zgjerimi i koridoreve të shkollës
- 1.1.4. Sigurimi i hapësirës për punë individuale me nxënës me nevoja të veçanta

1.2. Pajisja me libra, bibliotekë dhe kënde leximi

- 1.2.1. Sigurimi i librave të shumtë dhe të ndryshëm, të përshtatshëm për moshat e nxënësve
- 1.2.2. Sigurimi i raftëve për vendosjen e librave
- 1.2.3. Pajisja e bibliotekës me tavolina dhe karriga në mënyrë që nxënësit të kenë hapësirë të mjaftueshme për të lexuar
- 1.2.4. Pajisja me një kompjuter

1.3. Sigurimi i pajisjeve teknologjike

- 1.3.1. Sigurimi i projektorëve
- 1.3.2. Sigurimi i tabelave të mençura

1. 4. Sigurimi i materialeve (mjeteve për kabinete)

- 1.4.1. Pajisja e kabineteve me materialet e nevojshme që nevojiten për të realizuar mësimin praktik dhe lidhjen e tij me teorinë.
- 1.4.2. Pajisja e kabineteve me dollape, banka dhe karrige të përshtatshme
- 1.4.3. Pajisja e kabineteve të shkencave me lavamane

1.5. Ndërtimi i tualeteve të veçanta për fëmijët me nevoja të veçanta

2. Mësimdhënia dhe të nxënit

Objektiva strategjike 2. Avancimi i cilësisë së mësimdhënësve përmes ngritjes profesionale të mësimdhënësve dhe motivimit për punë cilësore.

2.1. Mbjajtja e trajnimeve për mesimdhënes

2.1.1. Organizimi dhe mbajtja e trajnimeve me baze në shkollë dhe me kurse jashtë shkollës

2.1.2. Hartimi i pyetesorëve dhe mbajtja e intervistave me mësimdhënës lidhur me nevojën e zhvillimit profesional të tyre

2.1.3. Rritja e ofertave për trajnime pa pagesë si dhe zhvillimi i trajnimeve me bazë në shkollë.

2.2. Kategorizimi i mësimdhënësve

2.2.1. Rritja e pagës së mësimdhënësve në bazë të licencës dhe ngritjes profesionale të tyre, ku mësimdhënësit me licencë më të lartë dhe me ngritje profesionale do të kenë rritje të pagës

2.2.2. Mësimdhënësit mentorë do të monitorojnë studentët praktikantë dhe t' i ndihmojnë ata lidhur me praktikën pedagogjike

2.3. Ndarja e mirënjohjeve për mësimdhënësit

2.3.1. Çdo fundvit shkollor do të ndahen mirënjohje për mësimdhënësit e dalluar

2.3.2. Ndarja e mirënjohjeve për mësimdhënësit që dalin në pension

2.3.3. Motivimi i mesimdhënësve duke i shpërblyer me lëvdata

2.4. Bashkëpunimi kolegial dhe shkëmbimi i përvojave

2.4.1. Çdo muaj do të mbahen takime të rregullta me mësimdhënës ku do të bashkëpunojnë dhe të shkëmbejnë përvojat e tyre

2.4.2. Mbjajtja e mbledhjeve të rregullta të Aktiveve profesionale

2.5. Gjetja e donatorëve të ndryshëm për investime në shkollë

2.5.1. Rregullimi i bashkëpunimit me DKA- në dhe MASHT si dhe forcimi i bashkëpunimit për të funksionalizuar sistemin e licencimit, ku mësimdhënësit që kanë licencën e avancuar, mentor dhe meritore të shpërblehen edhe në pagë

3. Bashkëpunimi dhe partneritetet (komuniteti, autoritetet, donatorët, kompanitë)

Objektiva strategjike 3. Sigurimi i donacioneve përmes sigurimit të donatorëve.

3.1 Bashkëpunimi me OJQ dhe komunitetin

3.1.1 Kontaktimi me OJQ të ndryshme me ta lidhur me sigurimin e donacioneve për shkollën.

3.1.2. Komunikimi me komunitetin për sigurimin e fondeve

3.1.3 Planifikimi i aktiviteteve të përbashkëta me komunitetin siç është shfaqje e përbashkët, ekspozitë, program festiv.

4. Gjithëpërfshirja

Objektiva strategjike 4. Krijimi i kushteve të barabarta për arsimim dhe edukim të nxënësve në shkollë

4.1. Përkrahja dhe ofrimi i ndihmës për nxënësit me nevoja të veçanta

4.1.1. Identifikimi i nxënësve me nevoja të veçanta

4.1.2. Angazhimi i asistentëve dhe mësimeve mbështetëse për këta nxënës

4.1.3. Hartimi i planeve individuale për nxënësit me nevoja të veçanta

4.1.4. Sigurimi i mjeteve didaktike të nevojshme për punë me këta nxënës

4.1.5. Rritja e bashkëpunimit me DKA- në për ndarjen e mjeteve buxhetore për këta nxënës

4.2. Fuqizimi i bashkëpunimit mësimeve mbështetëse- mësues klase

4.2.1. Mbajtja e sesioneve informuese nga mësimeve mbështetëse lidhur me rëndësinë e edukimit për fëmijët me nevoja të veçanta

4.2.2. Ofrimi i ndihmës në përpilimin e planeve individuale si dhe përzgjedhjes së teknikave adekuate për këta nxënës

4.2.3. Mbajtja e kontakteve të vazhdueshme lidhur me përparimin e nxënësve në fusha të ndryshme

4.3. Sigurimi i psikologut në shkollë

4.3.1. Konsultimi me komunitetin për sigurimin e shërbimit të psikologut derisa ta sigurojë shkolla atë

4.4. Organizimi i aktiviteteve gjithëpërfshirëse

4.4.1. Do të mbahen aktivitete të ndryshme në shkollë të cilat kanë për qëllim zhvillimin e nxënësve në sfera të ndryshme

4.4.2. Në aktivitetet e organizuara do të marrin pjesë edhe nxënësit me nevoja të veçanta

4.5. Bashkëpunimi me Qendrat Burimore për mjetet e nevojshme për punë me nxënës me nevoja të veçanta

5. Performanca dhe përgatitja për jetë

Objektiva strategjike 5. Përkrahja e nxënësve për përmirësimin e performancës së tyre dhe aftësimin për jetë.

5.1 Krijimi i klubeve brenda shkollës

5.1.1 Sigurimi i klasave të cilat do të kthehen në klube,

5.1.2 Përzgjedhja e mësimitdhënësit për secilin klub

5.1.3 Bashkëpunimi me kolektiv për identifikimin e nxënësve për orientimin nëpër klube të caktuara.

5.1.4 Mbajtja e mësimit shtues me nxënës,

5.1.5 Mbajtja e mësimit plotësues me nxënësit që kanë nevojë në mësim.

5.1.6 Pjesëmarrja në gara të ndryshme,

5.1.7 Shpërblimi i nxënësve talentë dhe të dalluar të shkollës

5.2 Krijimi i qendrës për këshillim në karrierë

5.2.1 Mbajtja e konsultimeve me nxënës për këshillim në karrierë

5.2.1 Gjetja e bashkëpunëtorëve për ofrimin e mundësisë së takimeve këshilluese për orientim në karrierë edhe me njerëz profesionistë dhe jashtë shkollës.

6. Tabela e rreziqeve

Gjatë hartimit të Planit Zhvillimor të shkollës Dituria, u vlerësuan rreziqet që mund të ndikonin negativisht në zbatimin e suksesshëm të Planit. Identifikimi i supozimeve u bë gjatë analizës së gjendjes, ndërkaq vlerësimi i rreziqeve u bë gjatë hartimit të masave e aktiviteteve për realizimin e objektivave të Planit.

Rreziku	Gjasa 1- E vogël 2- Mesatare 3- E madhe	Ndikimi 1- I vogël 2- Mesatar 3- I madh	Masat parandaluese
Numri i vogël i donatorëve	E madhe	I madh	Ngritja e shkallës së planifikimit për rritjen e efikasitetit të mjeteve financiare.
Investimet e pakta nga komuna	Mesatare	I madh	Planifikim paraprak i shkollave për nevojat e tyre në mënyrë që Komuna pastaj të parashih nevojat e shkollave gjatë ndarjes së buxhetit. Rregullimi i bashkëpunimit me DKA-në dhe MASHT si dhe forcimi i bashkëpunimit për të funksionalizuar sistemin e licencimit, ku mësimdhënësit që kanë licencenc i avancuar, mentor dhe meritore të shpërblehen edhe në pagë.
Shkolla nuk ka pedagogë, nuk ka psikologë	E madhe	I madh	Bashkëpunimi dhe komunikimi efektiv me komunitetin për sigurimin e shërbimit deri sa të arrihet punësimi i një psikologu apo pedagogu.
Mungesa e bibliotekës dhe hapësirës për lexim	E madhe	I madh	Sigurimi Pajisja me libra, bibliotekë dhe kënde leximi. Sigurimi i librave të shumtë dhe të ndryshëm të përshtatshëm për moshat e nxënësve, sigurimi i raftëve për vendosjen e librave, pajisja e bibliotekës me tavolina dhe karriga në mënyrë që nxënësit të kenë hapësirë të mjaftueshme për të lexuar.

7. Buxheti

Në vijim është buxheti i detajuar për pesë vite i këtij plani të veprimit, i ndarë sipas fushave, sipas viteve dhe sipas burimeve të financimit (i shprehur në Euro).

Fusha	Burimi i financimit	Viti					Total
		2022	2023	2024	2025	2026	
Mjedisi i të nxënit	Buxheti komunal	8000€	13.300€	15.050€	6.000€	5000€	47.450€
	Donatoret dhe/ose Institucionet qendrore	2.500€	5.000€	4.000€	2.100€	2.800€	16.400€
	Total	10.500€	18.300€	19.050€	8.200€	7.800€	63.850€
Mësimdhënia dhe të nxënit	Buxheti komunal	2000€	3000€	3500€	3800€	3000€	15.300€
	Donatoret dhe/ose Institucionet qendrore	400€	700€	600€	290€	400€	2.390€
	Total	2.400€	3.700€	4.100€	4.090€	3.400€	17.690€
Bashkëpunimi dhe partneritetet (komuniteti, autoritetet, donatorët, kompanitë)	Buxheti komunal	150€	130€	120€	100€	110€	610€
	Donatoret dhe/ose Institucionet qendrore	200€	400€	500€	330€	200€	1.630€
	Total	350€	530€	620€	430€	310€	2.240€
Gjithëpërfshirja	Buxheti komunal	3.000€	6.000€	7.000€	6.800€	6.000€	28.800€
	Donatoret dhe/ose Institucionet qendrore	400€	700€	300€	250€	800€	2.450€
	Total	3.400€	6.700€	7.300€	7.050€	6.800€	31.250€
Performanca dhe përgatitja për jetë	Buxheti komunal	120€	160€	110€	200€	300€	890€
	Donatoret dhe/ose Institucionet qendrore	200€	200€	300€	270€	190€	1.160€
	Total	320€	360€	410€	470€	490€	2.050€

Totali: 117 080 Euro

Masat e parapara në këtë plan janë të gjitha të karakterit zhvillimor dhe investues, domethënë nuk përfshihen shpenzimet operative (pagat, shpenzimet komunale, shpenzimet për ngrohje e të tjera). Në mjetet e planifikuara për planin e ri, përfshihet pjesërisht vetëm mirëmbajtja e objekteve – në kuadër të investimeve kapitale nga të hyrat vetanake të Komunës së Prishtinës të dedikuara për arsim për vitet e mbuluara nga ky Plan Zhvillimor. Në këtë Plan Zhvillimor shpenzimet kryesore janë investimet në infrastrukturë.

Shtojcë

Informatat bazë të projektit

Emri i shkollës: Dituria

Titulli i projektit: Krijimi i bibliotekës

Kohëzgjatja e projektit: shtator, 2022 – qershor 2024

Buxheti: ≈ 23.600 €

Lokacioni: Kosovë

Në këtë dokument janë të paraqitura në detaje të gjitha hapat e projektit.

Qëllimi i projektit është krijimi i bibliotekës dhe ofrimi i mundësisë për nxënësit që të kenë qasje më të lehtë në leximin e librave të ndryshëm. Përmes kësaj, kam për qëllim që t'u sigurojë nxënësve një ambient të përshtatshëm dhe nxitës, që ndikon në përforcimin dhe nxitjen e dashurisë dhe shprehisë ndaj të lexuarit, përkatësisht kjo të ndikojë në zhvillimin e kulturës së të lexuarit.

Buxheti

Ndërtimi i bibliotekës : 10.000E

Librat (shkolllore, shkencore, lëtyrat, romane etj.) - 8000 €

2 kompjuterë- 500 €

1 Projektor – 100 €

Inventari (raftet e librave, tavolinat, ulëset) - 5000 €

SHPJEGIMI MË NË DETAJE I AKTIVITETEVE

1. Takimi me mësimdhënësit

Ky takim bëhet për të biseduar me mësimdhënësit lidhur me fillimin e implementimit të projektit. Shkëmbehen ide, mendime, praktika të ndryshme mes mësimdhënësve.

2. Takimi me prindër

Ky aktivitet do të mbahet në javën e parë të muajit **tetor** dhe ka për qëllim diskutimin me prindërit për rendësin e krijimit të një biblioteke dhe mundësitë e tyre financiare për të ndihmuar në ndërtimin e kësaj biblioteke

3. Takime me donator të ndryshëm:

Qëllimi i takimit është për të ju shpjeguar rendësin që ka për ne si shkolle krijimi i kësaj bibliotekë dhe mundësitë e tyre për ndihmë financiare për ndërtim

4. Takimi me DKA

Ky takim do bëhet për të shikuar mundësitë e tyre financiare për krijimin e kësaj bibliotekë, dhe sigurimin e një bibliotekiste që do të punoj në këtë bibliotekë

5. Ndërtimi i bibliotekës : Fillimi i ndërtimit të bibliotekës pas sigurimit të mjeteve financiare

6. Rregullimi i rafteve

Rregullimi i rafteve do të bëhet në bashkëpunim me prindërit, të cilët në baza vullnetare do të ndihmojnë në këtë aktivitet. Raftet do të jenë të renditura sipas grupmoshave nga poshtë-lart që t'i përshtaten nivelit të zhvillimit të nxënësve.

7. Sistemimi dhe regjistrimi i librave

Sistemimi dhe regjistrimi i librave bëhet nga bibliotekisti/ja që punësohet nga DKA në bashkëpunim me mësuesin dhe prindërit.

8. Rregullimi i ulëseve, tavolinave dhe pajisjeve tjera përcjellëse

Pasiqë të sistemohen të gjitha librat fillon rregullimi i ulëseve, tavolinave dhe pajisjeve tjera.

9. Inaugurimi i bibliotekës

Pasiqë përfundon pjesa teknike e rregullimit të bibliotekës, aktiviteti i radhës është inaugurimi i bibliotekës sonë me një ceremoni modeste.